



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 23
Prishtinë, më 10 Korrik 2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Driton Selmanaj, Mërgim Lushtaku, Muharrem Nitaj, Shqipe Pantina, Avdullah Hoti, Verica Qeraniq, Faton Topalli, Albert Kinolli, Zafir Berisha dhe Ali Lajçi.

Munguan: Andin Hoti,

Stafi mbështetës: Mehmet Simnica dhe Ajet Avdullahu.

Pjesëmarrësit tjerë: Besnik Osmani, Fitim Haliti, Shkëlqim Xhema nga ZKA, Gresa Maxhuni nga KDI, Isuf Zejna nga D+, Rabije Hyseni nga Kuvendi/Zyra për Informim, Besjana Bajrami nga Ekonomia Online dhe Fitim Sylejmani nga Informatat.com.

Mbledhjen e kryesoi: Driton Selmanaj, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtura më 29.06.2018;**
- 3. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve për raportin vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike në sektorin publik në Kosovë për vitin 2017;**
- 4. Shqyrtimi i raportit të performancës së ZKA-së për vitin 2017 së bashku me PVF- të e audituara;**
- 5. Të ndryshme.**

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtura më 29.06.2018

Përfundimi

Procesverbali i mbledhjes, të mbajtura më 29.06.2018, u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve për raportin vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike në sektorin publik në Kosovë për vitin 2017

Kryetari njoftoi se në takimin e javës se kaluar është shqyrtuar raporti vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike në sektorin publik në Kosovë për vitin 2017. Kanë mbetur vetëm të aprovohet një listë e rekomandimeve të përmirësuar dhe i propozoi komisionit të votojë listën të cilën kanë pranuar nga stafi më parë.

Përfundim

KMFP miratoi raportin vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike në sektorin publik në Kosovë, për vitin 2017, së bashku me rekomandimet e Komisionit Funkcional. Të njëjtat u vendos të adresohen për në seancë plenare.

4. Shqyrtimi i raportit të performancës së ZKA-së për vitin 2017 së bashku me PVF- të e audituara

Kryetari njoftoi se për të prezantuar këtë raport në komision i pranishëm është përfaqësuesi i Auditorit të Përgjithshëm, z. Besnik Osmani, të cilin e ftoi të bëjë një prezantim të raportit.

Besnik Osmani njoftoi që raporti i performancës është bazuar në instrumentet e matjes së performancës së Auditimit. Ai tha që për vitin 2016 se kanë përfunduar Raportin Vjetor të Auditimit, 92 Raporte të Auditimit të Rregullsisë, 4 Raporteve të Ndërmarrjeve Publike, 11 Raporte të performancës dhe 2 raporte të projekteve të financuara prej donatorëve. Ai njoftoi deputetët se kanë rritur bashkëpunimin me palët e interesit, në mënyrë të veçantë me sektorin e drejtësisë. Ai në fund theksoi se vlerësimet e punës së tyre janë prezantuar edhe në Raportin e BE-së për Kosovën.

Faton Topalli përgëzoi auditorin për punën e bërë. Ai theksoi që ajo që është shqetësuese, por që nuk ka të bëjë me Auditorin është implementimi i rekomandimeve. Ai tha që në institucionet qendrore 72% e rekomandimeve nuk janë implementuar, në institucionet e pavarura gjithashtu 72%, ndërsa në komuna 76%. Ai tha që nëse i krahasojmë raportet e viti 2016 për vitin 2015 dhe raportin e vitit 2015 për vitin 2014, kemi një rënie prej 8% të zbatimit të rekomandimeve. Pra, nuk është që kemi një qeverisje më të mirë. Ai në fund tha që qeverisja jonë e deritashme nuk ka qenë fare e përgjegjshme në implementimin e rekomandimeve të Auditorit.

Zafir Berisha tha që ne kemi rekomandime të pazbatueshme nga njësitë buxhetore të të gjitha niveleve të cilat përsëriten nga viti në vit. Ai e pyeti z. Osmanin se sa po merren parasysh të gjeturat e tyre dhe a po konsultohen në rast se ka ndonjë proces të ngritur për shkak të keqpërdorimeve.

Kryetari tha që ka lexuar raportin e kompanisë e cila e monitoron punën e Auditorit dhe tha të gjetura do të ishte mirë me i nda me ju. Ai përmendi shkurtimisht shkeljet në konstatuar në dosjet e personelit, te trajtimi i borxheve, te shpenzimet për mallra dhe shërbime, te prokurimin dhe në fund te stoqet. Ai tha që shkeljet të cilat gjinden te ju, pesha e tyre është më e madhe sepse ju po na i sjellë të dhënat për të gjitha institucionet e tjera dhe pyeti Osmanin se cila ishte përgjigjja e tij për këtë.

Besnik Osmani tha ka një formë tjetër të raportimit dhe këtu mund të ketë një formë të lajthitjes. Ai përmendi që kjo është kompani private që e ka bërë auditimin dhe nuk e ndjekin formatin e institucioneve publike. Ai tha ka shumë rekomandime që janë zbatuar, mirëpo tha që kanë ende çështje të cilat po punojnë. Lidhur me pyetjen e z. Berisha tha që bashkëpunimi me institucionet relevante është duke vazhduar dhe kemi raste kur këto institucione kthehen te ne për argumente shtesë, por që tash ai nuk është i gatshëm për të folur për rezultatet e këtyre hetimeve.

Zafir Berisha pyeti po ashtu që nëse auditorët e brendshëm bashkëpunojnë me ju apo shfrytëzohen për të mbuluar keq menaxhimin e brendshëm?

Faton Topalli pyeti se në sa raste indikative kanë njoftuar Kryeprokurorin e Shtetit?

Besnik Osmani njoftoi se për vitin paraprak kanë qenë 87 raste. Ai për pyetjen e z. Berisha tha që në rastet kur ka një auditor të brendshëm e lehtëson shumë punën e tyre, mirëpo që nuk kanë shumë siguri për punën e auditorëve të brendshëm.

Avdullah Hoti pyeti se si mendoni të rishikoni strukturën organizative që auditimi i performancës mos me qenë i veçantë. Pra, i implikon plani i ri strategjik në ndërrimin e kësaj strukture dhe si po e mendoni këtë gjë?

Verica Qeraniq pyeti se nga të dhënat e prezantuara nga ju nga 160 të punësuar, vetëm 4 nga ta janë të minoriteteve? Pse është një situatë e tillë?

Ahmet Isufi theksoi që është mirë që rekomandimet që jepen, të bëhet presion që të zbatohen, në mënyrë që në auditimin e ardhshëm të vërehet ndryshimi.

Besnik Osmani njoftoi se kanë të hapur në mënyrë të vazhdueshme konkursin për ekspert, në mënyrë të veçantë për komunitete, megjithatë theksoi që nuk dëshirojnë të krijojnë standarde të dyfishta në këtë punë profesionale sepse kjo nuk është përfaqësim politik. Njerëzit që angazhohen aty të mos jenë për shkak të etnitetit por për shkak të përgatitjes profesionale. Sa i përket pyetjes së z. Hoti ai tha që këtë javë do ta formalizojnë Planin Strategjik dhe se do të këtë ndryshim në strukturën organizative. Do të ketë një shtyllë të veçantë për ndërmarrjet publike, do të këtë një shtyllë të veçantë për auditimet e performancës.

Ali Lajçi tha që këto raporte kanë një qasje të mirë dhe marrin përmasat e veta të analizës dhe kryejnë funksionin e vet në bazë të institucioneve. Po ashtu tha që rekomandimet po mbesin në nivel të sugjerimeve.

Mërgim Lushtaku përgëzoi auditorin për punën e bërë. Po ashtu theksoi që me këtë punë rritet edhe kredibiliteti i Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Faton Topalli theksoi që zbatimi i rekomandimeve nuk është përgjegjësi e Auditorit, por e Kuvendit, e qeverisjes. Është çështje e jona, e deputetëve. Ai tha që shumica e rekomandimeve nuk janë adresuar. Prej 1162 rekomandimeve po i bie që 723 nuk janë realizuar. Mesatarisht janë diku rreth 30%. Ai në fund theksoi që në deputetët kemi më shumë mundësi për të bërë më shumë presion që këto rekomandime me u realizua.

Kryetari njoftoi që kanë për obligim që raportin ta dërgojnë në seancë plenare për miratim. Ai tha që bashkë me administratën kanë nxjerrë disa rekomandime. Rekomandimi kryesor është të miratohet Raporti vjetor i performancës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2017, së bashku me rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, si vijon: Zyra Kombëtare e Auditimit, në planit strategjik të Zyrës Kombëtare të Auditimit (2018 – 2021), si dhe në përgatitjen e planit të auditimit për periudhën 2018-2019, të rritë numrin e auditimeve të performancës, e veçanërisht për ndërmarrjet publike, në nivel qendror, si dhe në nivelin lokal. Zyra Kombëtare e Auditimit fokusohet në rekomandimet e dhëna nga Auditori i brendshëm sesa ato të dhëna a po zbatohen nga menaxhmenti i institucioneve. Zyra Kombëtare e Auditimit të fokusohet më tepër në mbikëqyrjen e zbatimin të rekomandimeve të dhëna nga Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike.

Avdullah Hoti tha që zhvillimi i auditimit të brendshëm është brenda Institucionit Publik, ndërsa këta bëjnë auditimin e përgjithshëm të jashtëm. Pra janë dy funksione të ndara.

Kryetari tha se rekomandimi i dytë është bërë që të ketë më shumë një fokus rreth asaj se sa po zbatohen rekomandimet, por gjithsesi mund ta heqim nëse ka mendim të përgjithshëm. Atëherë po e heqim këtë pikën e dytë.

Përfundim

KMFP, miratoi raportin e performancës së ZKA-së për vitin 2017 së bashku me PVF- të e audituara, si dhe rekomandimet. Të njëjtat vendos të adresohen për në Seancë Plenare.

5. Të ndryshme

Kryetari njoftoi deputetët se në takimin në Strugë janë nxjerrë një numër i madh i rekomandimeve ku është trajtuar më tepër Plani Strategjik i Zyrës Kombëtare të Auditimit. Njëra ndër rekomandimet ishte ndryshimi i ligjit për Auditorin e përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Driton Selmanaj